



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dostizuar Prilopno / Prototo Received / Dostizet	14.10.2022	2	viti god year
Organ / Shkëmbim Org / Shkëmbim	Skopje / Shkëmbim	Shtesa / Prilog Appendix	Sasia / Kështimit Quantity
	6233/2022		1/6



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.738/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.738/2022 të datës 25.08.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë fshati në Komunën e Prizrenit, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 14.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.695/2022 e datës 10.08.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër 01-Nr-016-46949 i datës 01.08.2022 i Komisionit Vlerësues të Komunës së Suharekës dhe Njoftimi me numër 01-Nr-016-47212 i datës 01.08.2022 i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Suharekës.

A r s y e t i m

Komuna e Suharekës duke u bazuar në dispozitat e nenit 34 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, fillimisht me datën 05.04.2022 ka njoftuar lidhur me konkursin, ndërsa me datën 26.04.2022 ka shpallur konkursin e jashtëm për emrin e grupit Specialistë të Ekonomisë me numër të referencës RN00008760 lidhur me pozitën “Inspektor i tregut” në Drejtorinë për Inspektion/Sektorin për Inspektive, për klasën e pozitës Profesional 1.

Ankuesi me datën 26.04.2022 ka aplikuar në konkursin e lartcekur.Fillimisht sipas njoftimit 01-Nr-016-30189 të datës 23.05.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Suharekës, nuk ka qenë i përfshirë në listën e ngushtë. Përmes Vendimit 01-Nr-016-30212 të datës

23.06.2022 nga ana e Udhëhqësit të Burimeve Njerëzore , të njëjtit iu është refuzuar aplikacioni me rastin e aplikimit, me arsyetimin se nuk i është vërejtur diploma e studimeve, tek certifikata e gjykatës me të cilën dëshmon se nuk është në hetime nuk është vërejtur data e lëshimit si dhe me rastin e përvojës së punës referenca e punës për ankuesin nuk posedon datën e lëshimit dhe e njëjta nuk është e vërtetuar dhe e nënshkruar, mirëpo të njëjtit pas parashtrimit të ankesës lidhur me refuzimin e aplikacionit, i është aprovuar sipas Vendimit 01-Nr-016-31732 te dates 30.05.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Suharekës, me ç' rast sipas Njoftimit 01-Nr-016-31744 të datës 30.05.2022 ankuesi është përfshirë në listën e ngushtë dhe për të cilën procedurë ka qenë i përfshirë në të gjitha fazat e rekrutimit dhe pas intervistës me gojë, bazuar në njoftimin me numër 01-Nr-016-45253 të datës 26.07.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Suharekës, i njëjti është njoftuar lidhur me pikët e arritura, gjithsejtë 65.2 pikë, duke u renditur i dyti (2-ti) në listën përfundimtare.

I pa kënaqur me rezultatin përfundimtar mbi përzgjedhjen e kandidatit fitues, brenda afatit ligjor përmes portalit per rekrutim elektronik, ankuesi ka parashtruar ankesë tek Komisioni për vlerësim, me pretendimet ankimore se i është bërë padrejtësi lidhur me këtë procedurë te konkurrimit, se nuk i është dhe mundësia ti shoh pikët e kandidatëve tjerë konkurrues si dhe afati për ankesë ka qenë i shkurtër vetëm tre ditë.

Me datën 01.08.2022, Komisioni për vlerësim përgjegjës për vlerësimin e procedurave të lartcekura në Komunën e Suharekës, ka nxjerrë Vendimin me numër 01-Nr-016-46949, sipas të cilit e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar dhe e ka lënë në fuqi Njoftimin me numër 01-Nr-016-45253 të datës 26.07.2022 lidhur me rezultatin përfundimtar mbi përzgjedhjen e kandidatëve fitues.

Ankuesi i pa kënaqur me vendimin e komisionit të vlerësimit të Komunës së Suharekës lidhur me refuzimin e ankesës se tij, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 25.08.2022, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 4977/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se i njëjti nuk është vlerësuar drejtë në mënyrë të drejtë dhe se i njëjti nuk është pyetur në mënyrë profesionale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës komfor dispozitave të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 05.09.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Komuna e Suharekës, ndërsa me datën 12.09.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Komuna e Suharekës me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Me datën 07.10.2022, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin VK.nr.110/2022 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit Nr.Prot:4977/2022 të datës 25.08.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës

për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e ankuesit e parashtruar tek portali elektronik për Komisionin e vlerësimit në Komunën e Suharekës; Vendimin 01-Nr-016-46949 të datës 01.08.2022 të komisionit për vlerësim në komunën e Suharekës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 05.09.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 12.09.2022 nga Komuna e Suharekës me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Konkursin e datës 05.04.2022 me numër të referencës RN00008760; Autorizimin 01-Nr-016-19497 të datës 31.03.2022 lidhur me shpalljen e konkurseve; Kërkesën 01-Nr-104-8269 të datës 08.02.2022; Shkresën zyrtare të datës 08.02.2022 nga Komuna e Suharekës; Njoftimin 01-Nr-016-20586 të datës 06.04.2022; Listën e aplikantëve konkurrues përmes SIMBNJ; Vendimin për themelimin e komisionit të vlerësimit 01-Nr-412-34404 të datës 09.06.2022; Formularin e vlerësimit-kriteret e zgjedhjes së ngushtë të datës 23.05.2022; Formularin për vlerësimin individual të jetëshkrimit, cv të kandidatëve për vendin e punës; Procesverbalin e datës 19.07.2022 të komisionit të vlerësimit; Testin me gojë të datës 25.07.2022; Njoftimin 01-Nr-016-30189 të datës 23.05.2022 për vlerësimin paraprak të kandidatëve; Njoftimin 01-Nr-016-31744 datës 30.05.2022 për listën përfundimtare të kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet; Shkresën zyrtare 01-Nr-016-45253 të datës 26.07.2022; Njoftimin 01-Nr-016-47212 të datës 01.08.2022 lidhur me listën përfundimtare; Renditjen përfundimtare të kandidatëve tek SIMBNJ të datës 26.07.2022; Aplikacionin e kandidatit të datës 10.05.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, formularët e vlerësimit, ID-në dhe certifikatën nga gjykata; Formularin e vlerësimit lidhur me kriterin e zgjedhjes së ngushtë të datës 23.05.2022; Aplikacionin e kandidatit A.B të datës 26.04.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, formularët e vlerësimit, ID-në certifikatën nga gjykata si dhe Vendimin 01-Nr-016-30212 të datës 23.05.2022 lidhur me refuzimin e aplikacionit; Vendimin 01-Nr-016-31732 të datës 30.05.2022 lidhur me aprovimin e ankesës së ankuesit për përfshirjen në listën e ngushtë; Formularët për vlerësimin individual të kandidateve për vendin e punës të datës 25.07.2022 për ankuesin; Pyetjet nga testimi me gojë për kandidatet aplikues të datës 25.07.2022; Formularin për vlerësimin individual të jetëshkrimit cv të kandidateve për vendin e punës për ankuesin; Procesverbalin e datës 19.07.2022 të komisionit të vlerësimit lidhur me përcaktimin e kriterëve për vlerësimin individual të jetëshkrimit për kandidatet aplikues; Aplikacionin e kandidates V. K të datës 04.05.2022 së bashku me dëshminë mbi përgatitjen profesionale dhe atë të punës, formularët e vlerësimit dhe certifikatën nga gjykata; Vendimin VK.nr.110/2022 të datës 07.10.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pa bazuar, sepse:

Pasi i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses si dhe të gjitha provat e lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se kriteret e konkursit për emrin e grupit „Specialist të ekonomisë, në Komunën e Suharekës, i shpallur sipas konkursit me numër të referencës RN00008760 lidhur me pozitën “Inspektor i tregut” në Drejtorinë për Inspektion/Sektori për Inspektime”, për klasën e pozitës Profesional 1, kanë qenë si në vijim:

- *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS-Fakulteti Ekonomik.*
- *Kualifikime të posaçme: Fakulteti Ekonomik.*



- *Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas shqyrtimit të provave dhe pretendimeve ankimore të ankuesit, ka konstatuar se për pozitën e lartcekura kanë aplikuar dhjetë (10) kandidatë, ndërsa në listën e ngushtë janë përfshirë fillimisht dy (2) kandidat, pastaj me rastin e aprovimit të ankesës së ankuesit nga Njësia e Burimeve Njerezore, i njëjti është përfshirë në listën e ngushtë dhe lista përfundimtare me kandidatët e listës së ngushtë ka qenë në përbërje prej tre (3) aplikantëve. Pas përfundimit të procedurave të pranimit, vlerësimit paraprak, vlerësimit të intervistës me gojë dhe vlerësimit të jetëshkrimit, ankuesi nga ky proces është vlerësuar me pikë të përgjithshme prej 65.2 pikë gjithsejtë dhe se i njëjti është vlerësuar nga Komisioni i pranimit në pajtim me nenin 16 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është e përcaktuar se: "1.Vlerësimi i kandidatëve kryhet nga Komisioni i Pranimit i themeluar në pajtim me nenin 17 dhe/ose përkatësisht nenin 18 të kësaj Rregulloreje. 2.Vlerësimi i kandidatëve, përfshin, sipas radhës: 2.1. vlerësimin nëpërmjet një testimi me shkrim; 2.2. vlerësimin e jetëshkrimit/CV, dhe 2.3. vlerësimin nëpërmjet një interviste me gojë", ndërsa pas shqyrtimit të pretendimit ankimor të ankuesit se i njëjta nuk është vlerësuar meritore dhe i është bërë diskriminim nga ana e Komisionit të vlerësimit, Kolegji ka konstatuar se ky pretendim është i pa bazuar dhe jo ligjor, pasi që në rastin konkret ankuesi me datën 01.08.2022 sipas Njoftimit me numër 01-Nr-016-47212 është njoftuar lidhur me rezultatet e vlerësimit për pozitën e lartcekura, i shpallur nga Udhëheqësi i Personelit në Komunën e Suharekës, i cili ka fituar pikët e përgjithshme prej gjithsejtë 65.2 pikë, duke u renditur i dyti (2) në listën përfundimtare të këtij njoftimi.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon se gjatë vlerësimit të intervistës me gojë është pyetur në mënyrë joprofionale nga ana e Komisionit të Vlerësimit, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të nenit 23 paragrafit 3 dhe 4 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në të cilin është përcaktuar se: "Vlerësimi nëpërmjet intervistës me gojë 3.Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për Grupin përkatës që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim. 4.Intervista që zhvillohet është intervistë e strukturuar nga Komisioni i Vlerësimit i cili përgatit apo zgjedh grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën me gojë të cilat përgatiten në ditën e zhvillimit të intervistës", ka konstatuar se Komisioni i Vlerësimit me datën 25.07.2022 ka hartuar pyetjet e intervistës me gojë të cilat kanë qenë të përfshira për fushën në të cilën është shpallur konkursi konkretisht për pozitën në të cilën ka aplikuar, se pyetjet janë parashtruar njëjtë për të gjithë kandidatët konkurrues dhe se ankuesi dhe në bazë të dokumentacionit mbi formularin e vlerësimit individual të datës 25.07.2022, për pjesën e intervistës me gojë nga ana e Komisionit të Vlerësimit, është vlerësuar me gjithsejtë pesë (5) pikë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se Njësia e Burimeve Njerezore në Komunën e Suharekës, me datën 01.08.2022 ka publikuar Njoftimin me numër 01-Nr-016-47212 lidhur me renditjen përfundimtare për rezultatet e vlerësimit, për emrin e grupit „Specialist të Ekonomisë” lidhur me pozitën "Inspektor i tregut", në Drejtorinë për Inspektion/Sektorin për Inspektime, në Komunën e Suharekës për klasën e pozitës Profesional 1, në të cilën janë përfshirë emrat e kandidatëve sipas pikëve të arritura dhe të përzgjedhur në bazë të pikëve të grumbulluara, e që del se kandidati A. K është

shpallur kandidati më i suksesshëm dhe fitues lidhur me këtë pozitë me gjithsejtë 78.4 pikë të arritura ndërsa ankuesi është renditur i dyti me gjithsejtë 65.2 pikë të arritura. Kolegji ndërlidhur me këtë fakt, konstaton se publikimi i listës përfundimtare me emrat e kandidateve fitues nga ana e Njesisë së Burimeve Njerëzore e Komunës së Suharekës, është bërë në pajtim me nenin 9 dhe paragrafin 2 të nenit 25 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, në të cilin përcaktohet se: *"2.Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues"*, dhe në këtë kuptim ankuesi është renditur i dyti (2) në këtë listë me gjithsejtë 65.2 pikë të arritura, e që bazuar në dispozitën e lartcekur i njëji nuk ka arritur të mbledh pikët e mjaftueshme për tu përzgjedhur në radhët e kandidatëve fitues andaj edhe pretendimi ankimor i ankuesit në kuptim se i njëjti nuk është vlerësuar drejtë nga ana e Komisionit të vlerësimit është i pa bazuar dhe jo ligjor.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara nga Komuna e Suharekës lidhur me dosjen e kandidatit të përzgjedhur lidhur me pozitën e lartcekur dhe në këtë kuptim, ka konstatuar se Komisioni i Pranimin me rastin e përzgjedhjes së kandidatit A.K për emrin e grupit „*Specialist të Ekonomisë*” lidhur me pozitën “Inspektor i tregut”, në Drejtorinë për Inspektion/Sektorin për Inspektime, në Komunën e Suharekës për klasën e pozitës Profesional 1, si kandidati i cili ka grumbulluar pikë më së shumti në raport me kandidatët e tjerë, ka vepruar në pajtim me nenin 21, 22, 23 dhe 24 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: *"24. Shuma e pikëve të përfituara nga se cili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, japin vlerësimin përfundimtar të kandidatit"*.

Ndërlidhur me përvojën profesionale të kandidatit të përzgjedhur nga kjo procedurë e rekrutimit, kolegji ka analizuar dëshmitë lidhur me dosjen e tij dhe ka konstatuar si në vijim: se i njëjti posedon Diplomën me numër Nr.478 të datës 14.08.2015, të lëshuar nga Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”, me të cilin dëshmohet se ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Ekonomik me datën 03.06.2015 dhe ka marrë titullin Baqelori i arteve në menaxhment ndërkombëtar (BA) me gjithsejtë 180 pikë-ECTS, po ashtu i njëjti posedon Diplomën me numër Nr.388 të datës 22.07.2020, të lëshuar nga Universiteti i Prizrenit “Ukshin Hoti”, me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet master në Fakultetin Ekonomik me datën 30.06.2020 dhe ka marrë titullin Master shkencor në kontabilitet dhe auditim me gjithsejtë 120 pikë-ECTS. Ndërsa ndërlidhur me përvojën e punës, i njëjti posedon: kontratën e marrëveshjes për shërbime të veçanta të datës 28.05.2018 e lidhur ndërmjet tij dhe komunës së Suharekës, me të cilën dëshmohet se i njëjti ka punuar në pozitën si “Zyrtar për inkasimin e të hyrave vetanake” në Drejtorinë për Ekonomi Buxhet dhe Financa nga periudha prej 28.05.2018-27.11.2018, kontratën e marrëveshjes për angazhim në masën aktive të tregut të punës të datës 01.08.2019, e lidhur ndërmjet tij, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunës së Suharekës, me të cilën dëshmohet se ka qenë i angazhuar si Praktikant pranë kësaj komune konkretisht zyrës së punësimit nga periudha prej 01.08.2019-31.01.2020, kontratën e marrëveshjes për shërbime të veçanta të datës 22.06.2020 e lidhur ndërmjet tij dhe komunës së Suharekës, me të cilën dëshmohet se i njëjti ka punuar në pozitën si “Zyrtar për inkasimin e të hyrave vetanake” në Drejtorinë për Ekonomi Buxhet dhe Financa nga periudha prej 22.06.2020-21.12.2020 si dhe vërtetimin me numër Nr.V 01/22-1 të datës 02.03.2022 e lëshuar nga Ndërmarrja B.I. “Profinancë”, me të cilën dëshmohet se i njëjti ka qenë në marrëdhënie të punës në pozitën si “Kontabilist” nga periudha 01.09.2021-28.02.2022. Andaj ndërlidhur me këtë, Kolegji ka



konstatuar se kandidati i përzgjedhur lidhur me pozitën e lartcekur i plotëson kushtet e konkursit për fushën e arsimimit të kërkuar si dhe përvojën e punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se Zyra e Personelit në Komunën e Suharekës, me rastin e publikimit të rezultateve përfundimtare sipas Njoftimit me numër 01-Nr-016-31744 të datës 30.05.2022 lidhur me renditjen përfundimtare për rezultatet e vlerësimit për emrin e grupit „Specialist të Ekonomisë“, për pozitën “Inspektor i tregut”, në Drejtorinë për Inspektion/Sektori për Inspektive, në Komunën e Suharekës për klasën e pozitës Profesional 1, si dhe Vendimi me numër 01-Nr-016-46949 i datës 01.08.2022 i Komisionit Vlerësues të Komunës së Suharekës, kanë vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.6/L-114 për Zyrat e Publikë, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative dhe nenin 25 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.738/2022, datë 14.10.2022.

Ardita Perguku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Suharekës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Suharekës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.